



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 20 shtator 2019, në mbledhjen e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.31 dhe filloi në orën 13;30.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, përveç Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes dhe Mjedisit – DPUMM, Gëzim Namani Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, dhe Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 korrik 2019

Njëzëri miratohet pa vërejtje, plotësim ndryshime.

2. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 20120 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021 – 2022

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth propozim buxhetit të Komunës për vitin 2020 dhe parashikimeve buxhetore për vitet 2021/2022, ndër të tjera theksoi, do të mundohem të jem i shkurtër rreth kësaj çështje ngase në qershor të këtij viti kemi miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB, dokument i cili është përgatitur dhe miratuar në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/01 të Ministrisë së Financave, kurse tani është përcjell buxheti final i Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe projeksionet për vitet 2021-2022, dokument i cili është bazuar në Qarkoret Buxhetore 2020/1 dhe 2020/02, prandaj ndryshimet nga KAB tek Qarkoja Buxhetore 2020/01 dhe 2020/02 në bazë të të cilit është deshtë të kemi një përfundim sa i përket shifrave të cilat i keni para vetës në materialin e dërguar. Nga KAB deri në buxhet final diferenca është rreth 129.000.00 € më e rritur për shkak të buxhetit të Teatrit që është përfshirë si shumë e re shtesë sepse ashtu është paraparë me ligj dhe për këtë shkak nuk ka qenë në Qarkoren 2020/01 dhe për këtë arsye kemi këtë diferencë të saktë prej 129.940.00 € më shumë.

Të gjithë ju që keni analizuar këtë propozim buxheti, besoj që keni mund ta vëreni një problem, nëse mund ta quaj kështu, ka të bëjë nëpër kategori ekonomike bazuar në KAB-in ku del se është një zvogëlim tek kategoritë kapitale e që kategoria më e ndjeshme, kurse ka rritje tek kategoria mallra dhe shërbime, mirëpo njëkohësisht ka zvogëlim tek kategoria paga dhe mëditje. Kjo është e bazuar konkretisht në Qarkoren Buxhetore 2020/02 e cila ka caktuar kufijtë final të buxhetit final por edhe të kategorive ekonomike, do të thotë, të gjitha kategoritë ekonomike janë caktuar nga Ministria e Financave në bazë të Qarkores 2020/02, dhe ato vetëm është dashtë të përshtaten përmes planifikimeve tona që kanë qenë në KAB dhe planifikimeve të cilat janë tani. Ajo që mund të them se nuk është më e mira ka të bëjë me investimet kapitale ku janë heqë 300.000.00 € dhe si rrjedhojë ose dashtë të heqën projekte ose të reduktohen shifrat në mënyrë që shuma në fund të jetë e barabartë e që patjetër është dashtë të veprohet kështu.

Problem tjetër që ne e kemi ngritë edhe në Asociacion të Komunave të Kosovës por edhe në Kolegrium për Buxhet dhe Financa, ka qenë edhe çështja që ka të bëjë me planifikimet tona, përkatësisht zvogëlimi i buxhetit për kategorinë paga dhe mëditje, dhe që shpresojmë që Ligji për Paga duhet të zbatohet nga muaji dhjetor i këtij viti. Pra nëse në KAB kemi planifikuar një shumë tjetër, në këtë rast në Qarkoren Buxhetore 2020/02 është zvogëluar për 803.000.00 €, dhe nëse shtojmë edhe buxhetin për paga të punëtorëve të Teatrit të Qytetit, atëherë buxheti për paga është zvogëluar për 163.839.00 €.

Ka pasur dilema të mëdha për shkak se buxheti për paga është ndarë sipas Ligjit për Paga i cili është miratuar dhe në këtë kontekst shumica e pozitave janë konform këtij ligji, mirëpo dihet që shumë pozita të shërbyesve civil nuk janë të specifikuara në cilat grada bien ato pozita dhe me cilin koeficient do të paguhet, andaj edhe janë paraqitur probleme sa i përket planifikimit sepse nuk është ditë saktë në cilën gradë janë paraparë të vendosen. Ministria përkatëse ka formuar një komision dhe na është përgjigjur se janë duke punuar në një rregullore që do ti specifikoj pozitat e shërbyesve civil në mënyrë që të jenë të ngjashme në të gjithë Kosovën, mirëpo akti ende nuk është sjellë dhe nuk jemi saktë në dijeni rreth pozitave të klasifikuara, prandaj sigurisht keni edhe në propozim vendim që është futë një nen i cili thotë se nëse aplikohet ligji atëherë nuk kemi bazë të mjaftueshme monetare.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave në takimin e Kolegriumit për Buxhet dhe Financa, e potencon, ju jeni të obliguar ti zbatoni këta kufij, kurse në bazë të rregulloreve që do të nxjerrën nga niveli qendror atëherë ne jemi të obliguar që këtë masë monetare ta mbulojmë gjatë vitit, por duhet të jemi të kujdesshëm që gjatë përpilimit të projekt buxhetit të lëm fleksibilitet në mënyrë që gjatë vitit të mund të bëjmë harmonizime të brendshme nga ana e Komunave dhe shpresoj që kjo të ndodhë.

Në KAB kemi planifikua të zvogëlojmë kategorinë mallra dhe shërbimeve dhe të ngritim kategorinë e investimeve kapitale, përkatësisht jemi afër edhe kategorisë paga dhe mëditje edhe përkundër këtyre ndryshimeve që kanë ndodh dhe që na kanë vënë në pozitë të vështirë por kemi qenë të obligueshëm sepse Ministria kështu i ka caktuar kufijtë nëpër kategori ekonomike.

Pra kjo ishte në pika të shkurtër sa i përket ndryshimeve ndërmjet Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe projektbuxhetit të përgatitur, për të cilin paraprakisht kemi pasur edhe dëgjim publik me Ministrinë e Financave para se të lëshohet KAB-i ku kërkesa ime ka qenë që kategoria paga dhe mëditje të rritet në dëm të kategorive tjera sepse këtë kufi e kemi por mundësisht që KAB-i të jetë i përafërt me Qarkoren Buxhetore finale, mirëpo tek kategoria mallra dhe shërbime ka ndikuar shumë sepse është një diferencë e madhe nëse krahasojmë KAB-in dhe kufijtë final.

z.Avni Fetahu, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës ku edhe do t'i diskutojmë të gjitha çështjet.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit dhe aty do ti shpalosim të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tona.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, gjithashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e rekomandojmë këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në Kuvend.

z.Mehmet Gashi, theksoi, i kam krahasuar ndryshimet nga KAB dhe projekt buxhetit që na është sjellë për shqyrtim, mirëpo deshta një sqarim nga Drejtori, ndryshimet tek pagat më së shumti janë bërë te Kuvendi, përkatësisht nga 266.043.00 € ka rënë në 172.653.00 € për vitin 2020, ndërsa për vitet 2021-2022 nuk është ndryshuar mirë, por me rritjen e pagave nga muaji dhjetor ky buxhet nuk është i mjaftueshëm, çështje të cilën unë e kuptoj që nëse nuk janë të mjaftueshme Ministria duhet t'i kompensoj me rishikim, mirëpo tek kategoritë tjera nuk është shpreh kjo çështje, por vetëm tek Kuvendi është zvogëluar.

Pastaj po vërej që tek stafi numri është rritë, besoj fjala është për arsim, mirëpo këtu stafi është rritë e buxheti ka mbet i njëjtë. Po ashtu nuk e kuptova tek totali i përgjithshëm që i referohet stafit të administratës, ka të bëjë me dhjetë punëtor shtesë, nëse nuk gaboj fjala është për Teatrin e Qytetit sepse nuk ka qenë në KAB. Buxheti për kategorinë mallra dhe shërbime është rritë, në vend që të rritej kategoria e pagave, çështje për të cilën e arsyetoj Drejtorin sepse kjo varet prej Ministrisë ashtu siç e kanë rekomanduar, mirëpo tek Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit kemi një rritje të dukshme, sigurisht është për mirëmbajtje, pastaj kemi rritje rritje edhe tek Drejtoria e Arsimit dhe mirë që është rritë sepse për arsim ka nevojë buxhet më i madh.

Për fund, është mirë që të keni parasysh tek pagat për Kuvend në mënyrë që të mos kemi mungesa pastaj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, lidhur me çështjen që parafolësi e ceku, edhe unë si Kryesues i Kuvendit kërkoj që të sqarohen gjërat në mënyrë që eventualisht të mos paraqitet ndonjë situatë e tillë ku pastaj do të pamundësonte edhe funksionimin eventual të Kuvendit për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm për kompenzimet e këshilltarëve.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, shqetësimin e juaj do ta bartja për Drejtorinë të Arsimit e cila është shumë më e madhe, megjithatë unë e potencova se në ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2020 do të ketë fleksibilitet dhe sigurisht gjatë vitit do të lejohet rialokim për me qëllim të plotësimit të këtyre llogarive të cilat sot po i shohim në listë të projektbuxhetit si në programe ashtu edhe në kategori ekonomike.

Këtë çështje e ka lehtësuar shumë edhe neni 4 i propozim vendimit sipas të cilit në një formë specifikohet që ne po miratojmë buxhet dhe po jemi në dijeni që nuk është i mjaftueshëm, dua të them se ne jemi në dijeni që në fillim se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm, mirëpo që stafi në total nuk është rritë në asnjë Drejtori, me përjashtim të stafit prej 12 punëtorëve të Teatrit të Qytetit të cilët janë cilësuar si

punëtorë shtesë. Në KAB dhe në Qarkoren Buxhetore 2020/01, tek Drejtoria e Arsimit mund të shihet në tabela se numri i punëtorëve është më i vogël se në Qarkoren Buxhetore 2020/02, por që është i njëjtë me vitin 2019, do të thotë nuk ka as zvogëlim as rritje, por rritja është e reflektuar në total për 12 punëtorë të Teatrit të Qytetit. Deri sa të nxjerrët akti nënligjor, nuk dihet saktë për secilin trup se çfarë do të punohet, shembull, në Kuvend nuk e di për secilin a do të jetë paga e njëjtë, si për ata që punojnë edhe për ata që nuk punojnë punë tjetër, por sugjerimi i Ministrisë që do të ketë fleksibilitet na bënë të ndjehemi pak më lehtë që gjatë vitit nuk do të kemi probleme për kategorinë paga dhe mëditje, kështu që pagat do t'i marrin të gjithë e si do të rregullohet kjo do të bazohet në ligj.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, secili punëtor që ka marrëdhënie pune mund të padit institucionin dhe shkohet me sanksion gjyqësorë apo edhe përmbarues, do të thotë bllokohet kontoja e Komunës, pra veprohet përmes Gjykatës, me dëshmi dhe arsyeshmëri ligjore. Nuk e di çfarë ka mëndu edhe Ministria në këtë aspekt, pastaj nuk po dëshiroj të ngarkoj as Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, por në takimin që e patëm me Kryetarët e Komunave dhe këshilltarët e kuvendeve të komunave, si asociacion është thënë se jem duke e bërë maksimumin, por pa asnjë letër në pozitivitete të Kuvendeve Komunale dhe qytetarëve. Drejtori i DBF z.Isuf Latifi është i obliguar që në ato korniza të dërguara nga Ministria, t'i vazhdoj, por mendoj që tek pjesa e Kuvendit si institucion duhet të kemi parasysh edhe niveli lokal edhe niveli qendror që pa Kuvend nuk mund të funksionoj as ekzekutivi. Së pari në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit si institucion duhet të ketë një buxhet sado minimal aq sa mund të lejohet për takime apo çfarëdo situatë tjetër, e jo të ketë ulje të buxhetit për Kuvendin e Komunës.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, sqarim, këtu jemi në mbledhje të Komitetit për Politik dhe Financa dhe te Kuvendi ne po e ndajmë këtë pjesën e pagave, kategoria e pagave dhe mëditjeve është e obligueshme me ligj, Ministria e Financave ose Qeveria ose Kuvendi Komunal është i obliguar ta zbatoj ligjin për paga dhe për këtë nuk duhet të kemi dilemë. Pastaj janë 10.000.00 € të ndara në kategorinë mallra dhe shërbime për nevojat të Kuvendit dhe nëse këto nuk mjaftojnë ne sot mund të dakordohemi që të zvogëlojmë buxhetin e ndonjë kategorie të ndonjë Drejtorie dhe të rrisim për mallra dhe shërbime të Kuvendit, por duhet ta kemi një vizion për çfarë po ndajmë, nëse sot jeni të pajtimit unë e them me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, kategoria për mallra dhe shërbime për Kuvendin e Komunës të rritet 20.000.00 € ose 30.000.00 €, pa asnjë problem sepse këtu është fleksibiliteti jonë që mundemi me vendosë, mirëpo te pagat është diçka tjetër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, planifikimin buxhetor e bënë Ekzekutivi i Komunës, më mirë do të ishte të mos hyjmë fare në debat sot sepse ne tani nuk mund të ndajmë konkretisht mjetet buxhetore për Drejtori, shembull, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ndan sera në dhjetor, andaj buxheti duhet të planifikohet. Një planifikim i ndonjë Drejtorie për të shtruar një rrugë në asfalt e ka mbështetjen tonë të plotë sepse e dimë që duhet të bëhet ajo punë, dua të them se nuk i kontestojmë projektet e nevojshme. Mandej kemi disa parashikime të cilat nuk dëshiroj ti cekë tani, por që ndahen mjete buxhetore dhe nuk shfrytëzohen kurrë praktik e cila është shumë e keqe ngase kemi disa mijëra euro që shkojnë suficit, prandaj buxheti duhet të shfrytëzohen brenda Podujevës e jo të shkoj suficit. Unë vërejta kryetarët komiteteve të fshatrave që kanë mbajtur takim dhe aty kanë qëndruar vetëm sa për ti qeshur Kryetarit por që të njëjtit edhe pse kanë pasë kërkesa të fshatrave nuk i kanë paraqitur fare, shembull, kryetari i Bellopojës i cili kishte potencuar se nuk kemi kërkesa për këtë fshat, andaj mendoj se me përfaqësues politik të tillë, t'ju besohet përfaqësimi i qytetarëve është tmerr. Për këtë takim tani është vonë sepse nuk mund të hy në analizë për të shtuar dhe hequr ndonjë projekt apo të propozohet rritja ose zvogëlimi i buxhetit prej ndonjë Drejtorie, mirëpo po ta dija para tri apo katër dite që është kjo mundësi sigurisht që do bënim ndonjë propozim edhe me subjektet tjera politike.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, sqarim shtesë lidhur me atë që parafolësi e ceku, për ndryshime buxhetore fjala ishte vetëm për çështje të Kuvendit kur e potencova që nëse nuk mjafto shuma e ndarë mund ta rrisim, por jo edhe për çështje tjera buxhetore. Asnjë prej materialeve të Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, që kërkon shpenzime nuk i është adresuar Kuvendit, por i është adresuar ose administratës komunale si shpenzim ose zyrës së kryetarit, përjashtim nëse në mënyrë specifike ka ndodh diçka, sikurse kemi rastin e shkuarjes në Shqipëri në vitin e kaluar, ose blerja e llastopëve, atëherë është shpenzim specifik i Kuvendit. Prandaj në qoftë se edhe gjatë vitit të ardhshëm nuk mjafton shuma e ndarë për ndonjë shpenzim të Kuvendit, atëherë buxheti do të merret prej ndonjë Drejtorie dhe nuk do të mbetet pa përfunduar, mirëpo dispozitat ligjore do të zbatohen pikë për pikë.

Pra kjo është që mos të kemi paqartësi dhe mos të themi që nuk e kemi ditë që ka mungesë të buxhetit.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, kryesuesi e hedh në votim dhe konstatoi se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, me 30.08.2019 kemi pranuar kërkesën e Shërbimit Spitalorë Klinik Universitarë të Kosovës – SHSKUK për dhënien e një parcele për ndërtimin e objektit apo aneksit të Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës i cili është themeluar me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë së vitin 2016. Ne para jush kemi sjell propozim vendimin e Kryetarit të Komunës sipas të cilit i është lejuar dhënia në shfrytëzim, përkatësisht parcela me nr.260, në sipërfaqe prej 5637m² në të cilën është ndërtuar spitali aktual dhe do të rrënohet objekti i vjetër i rëntgenit në vend të të cilit do të ndërtohet aneksi dhe kështu do të kompletohet Spitali i Përgjithshëm.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, lidhur me këtë pikë, siç keni vërejtur kemi një kërkesë të drejtpërdrejtë nga SHSKUK për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë. Objekti aktual i ri tani veç ka një vendim sipas të cilit ligjërisht është objekt i SHSKUK-së, mirëpo ky Institucion përmes ekspertëve të tyre dhe në koordinim të plotë me Komunën e Podujevës kanë paraqitë një draft elaborat me të cilin saktësohet se si do të jetë Spitali i Përgjithshëm i Podujevës. Sigurisht jeni në dijeni edhe për një Marrëveshje të Bashkëpunimit që është lidh për ndërtimin e një aneksi i cili do t'i ketë 120 shtretër. Projekti ideor i objektit aneks është duke u hartuar nga ekspertë mirëpo me këtë vendim i cili shpresoj që do të miratohet nga Kuvendi i Komunës, SHSKUK-së do t'ju hapet rruga që të zhvillojnë procedura të prokurimit për shpalljen e projektit zbatues si dhe ndërtimin e objektit aneks. Vlen të ceket se sipas ekspertëve të caktuar në objektin aktual do të jenë sallat e operacioneve, ndërsa në objektin aneks do të vendosen rreth 120 shtretër. Hapësira është kërkuar nga SHSKUK, e njëjta është proceduar edhe nga ne, mirëpo në fund është vendimi juaj dhe shpresoj që të ketë përkrahje nga ana juaj.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, pyetje për drejtorin parafolës, sa kuptova unë objekti 2 ku aktualisht është rëntgeni dhe mamografi do të rrënohet, andaj ku do të vendosen këto aparatura.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, sa i përket rëntgenit dhe mamografit, është një kompani e kontraktuar dhe ata vetëm po presin vendimin se kur do të fillojnë punën për zhvendosjen e tyre në objektin e ri të Spitalit të Përgjithshëm. Gjithashtu besoj që jeni në dijeni për fillimin e ndërtimit të objektit të ri të Emergjencës, në fakt krejt infrastrukturën që e objektit 2, vetëm me një plotësim standardi të kohës, do të bartet në objektin e ri të emergjencës, projekt ky i cili është një prej projekteve kapitale më të mëdha për shëndetësi dhe aty do të vendoset komplet infrastruktura e radiologjisë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, vetëm dëshiroj të ndërlihem paska në aspektin urban sa i përket parcelës së caktuar për ndërtimin e objektit të ri të emergjencës, hapësirë në të cilën ka qenë ish objekti i veterinarisë, pra ka kushte mjaft të mira, hapësirë të mjaftueshme dhe është lokacion i përshtatshëm për një objekt të tillë i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, sa për informacion, në mbledhjen e Kryetarit të komunës me Drejtor të Drejtorive, në bashkëpunim dhe miratim të Kryetarit kemi marr atë vendim që institucioneve shëndetësore t'ju bëjmë një decentralizim, t'i shpërndajmë paksa sepse mendoj ka qenë e pa drejtë që krejt lagjet e Podujevës por edhe të gjitha fshatrat të kalojnë gjithë qendrën e qytetit për të marrë një shërbim, andaj mendoj që për një të ardhme, më së shumti 10 vite, ta bëjmë një decentralizim më të gjerë. Element tjetër është edhe fakti që pritet të ndërtohen rrugë të reja magjistrale ndoshta edhe rrugë tjera me rëndësi të veçantë të cilat ndoshta do të kenë qasje të drejtpërdrejt në autostradë dhe magjistrale e që do të ishin të nevojshme për qasje sa më të shpejt në objektin e emergjencës dhe anasjelltas.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me korrigjim që në nenin 3 të propozim vendimit ku thuhet "...99 (nëntëdhjetë) vite", të përmirësohet, si vijon, "..... 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite".

4. Propozim vendimi për dhënien e Pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në vazhden e investimeve të KEDS-it kemi edhe dy kërkesa të reja për dhënie të pjesëve të pronave në shfrytëzim, përkatësisht njëra është tek Fabrika e armaturës, për shkak të kërkesës edhe të shume banorëve atje është e nevojshme ndërtimi i një trafostacioni të ri, andaj edhe është propozuar t'i ipet në shfrytëzim pjesa prej 30 m² për vendosjen e një trafo blindë, si dhe kemi kërkesën tjetër tek rruga "Ali Ajeti" kjo është kërkuar nga KEDS-i si trafo rezervë për qytetin në mënyrë që të evitohen lënia pa rrymë e qytetit në raste të prishjes apo diçka të ngjashme, kështu që me këto kërkesa besoj që do të përmbyllen investimet e KEDS-it në qytet, propozim vendimin e keni lexuar të gjithë besoj, andaj është mirë ta miratojmë sepse është në interes të qytetarëve.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë pikë sigurisht keni vërejtur në materialin e dërguar se kemi të bëjmë me një njësi kadastrale parcelë me numër 495/4 e cila ka 2 hektar e 30 ari, parcelë për të cilën kemi një kërkesë nga një qytetarë i fshatit Lupç i cili kërkon pronën për lulishte - prodhim bujqësor. Njëkohësisht mund të themi se pastrohet ajo hapësirë sepse në pjesën dërmuese të saj ka mbeturina, e që me dhënien në shfrytëzim do të ndikoi në përmirësimin e ambientit si dhe krijimin e vendeve të punës. Pra është propozim që të jepet në shfrytëzim me qira për 15 vite.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në parim gjithherë e kamë thënë që pronat komunale të lira të jepen në shfrytëzim me qira dhe të inkasojmë të hyra nga ato prona. Lidhur me këtë pikë dëshiroj të shtroj pyetje Drejtorin parafolës i cili e tha që për momentin e kemi një kërkesë direkt nga një person fizik.

Pra në bazë të ligjit, raste të tilla jepen përmes ankandit përkatësisht çmimi më i lartë i ofruar për qira e përcakton edhe fituesin, andaj si do të zhvillohet dhënia e kësaj prone i nderuari Drejtor.

Sa jam në dijeni anëtarët e komisionit vlerësues për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe anëtarët komisionit të ankesave, nuk e kanë as listën e pronave që ju kanë dhënë në shfrytëzim, të paktën unë e ngiti si shqetësim edhe të anëtarit të komisionit nga PDK, sepse çfarë kanë kërkuar ata nuk ju është ofruar. Në parim ky propozim do të shkoj në Kuvend për miratim dhe sigurisht do të merre përgjigje pozitive, përkatësisht ai person do të merr në shfrytëzim atë pronë sepse veç i ka sjellë e që unë nuk jam kundër këtij personi. Po ashtu Ekzekutivi duhet ta ketë një çmim për m² të dhënies me qira, duhet thuhet, shembull, klasa e 4 në këtë zonë, çmimi i fundit për m² duhet të jetë kaq, dhe kush ofron çmimin më të lartë e merr në shfrytëzim pronën përkatëse, pra kam vërejtje sepse nuk kemi çmim fillestar për qira të pronave publike, ose më tregoni sa është çmimi i një m² të qirasë për prona publike të Podujevës, pra nuk keni çmim dhe këtë po e ngriti si shqetësim, ngase do të ishte me rëndësi edhe për investitor të ndryshëm, qoftë nga jashtë qoftë të brendshëm, e që unë mendoj se nëse nuk ka çmim Drejtori i Drejtorisë përkatëse, atëherë mund të themi se ka keqpërdorim, nuk po them se ti Drejtor keqpërdor drejtpërdrejtë, por keqpërdorë formacioni që vjen deri aty, nuk po flas si interes politik por si interes komunal. Gjithashtu edhe anëtarët e komisionit vlerësues për dhënien e pronës në shfrytëzim fillimisht duhet të kërkojnë çmimin për m² në Podujevë, por që nuk e kanë kërkuar asnjëherë nga asnjëri kryetar i komisionit vlerësues apo komisionit të ankesave.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, pra pati pyetje konkrete nga parafolësi për Drejtorin e DPKGJ a ka çmim të caktuar për dhënien në shfrytëzim të pronave publike në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, para se të jap përgjigje, ne kemi prona shumë, e kemi edhe pushmoren e fëmijëve në Orllan e që për herë të katërt që e vëmë dhe nuk ka të interesuar. Çmimin e cakton oferta dhe kërkesa, ne e kemi vë çmimin me 3 euro m², 5 mijë euro në muaj nuk i ka jap askush e kemi zbritë çmimin deri me 1.25 € dhe sërish nuk ka ofertuar askush, këtë herë e kemi për qëllim me zbrit në 1 €, krejt kjo me qëllim që nëse ndokush e merr në shfrytëzim atë paluajtshmëri, më mirë ta marr me 1 € dhe të punësoj dikë se sa të mbetet ashtu siç është.

Sa i përket këtij propozim vendimi për lulishte, nuk do të thotë që do ta merr në shfrytëzim ai person.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i drejtohet Drejtorit parafolës, objektet afariste dhe pronat e paluajtshme – patundshmëritë, janë krejt tjetër sistem.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, sqarim shtesë, caktimi i çmimit tek dhënia e pronave komunale në shfrytëzim me qira asnjëherë, asnjë pronë nuk është jap pa u caktuar çmimi sipas ligjit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, çmimin e cakton Drejtoria përkatëse, nëse është pronë bujqësore e cakton Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të kualitetit të tokës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sërish i drejtohet Drejtorit parafolës, a mund të më tregosh sa është çmimi për këta 2 dy hektar tokë që keni propozuar për dhënie në shfrytëzim, nëse është konfidenciale në rregull mund të mos më tregoni, nëse jo tregojeni.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, nuk është konfidenciale kjo çështje sepse ajo publikohet në faqe zyrtare dhe në tabelën e shpalljeve, pra caktohet në njoftim dhe në aplikacion, çmimin e jep Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bazë të kualitetit të tokës, ne shkojmë varësisht me 5 cent, 3 cent për m², e jo për ari, varësisht nga toka.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, atëherë pra Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në seancën e Kuvendit të datës 23.09.2019, të përgatit çmimin për këtë ngase ne do të votojmë për ose kundër këtij propozim vendimi, mirëpo një gjë e tillë nuk është sjellë asnjëherë.

Pra të thotë ai, shembull, për 2 hektar e 30 ari, çmimi për këtë pronë është 3 cent, ndërsa secili anëtar i komisionit vlerësues nga secili subjekt pastaj të voton dhënien e kësaj prone nën atë çmim, mandej konsultohemi ne dhe është çështje, por për të votuar për ose kundër, Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duhet të jetë në dijeni për çmimin minimal të dhënies në shfrytëzim për 2 hektar e 30 ari, kjo ngase ne kemi në propozim për votim në Kuvend dhe aty e merr legjitimitetin e jo tani të votojmë për çmimin apo të fillohet me ndërtim në atë vend e pastaj të fillohet me procedura, jo të paktën unë kërkoj të respektohen procedurat.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, këshilltari parafolës po kërkon diçka që është jashtë ligjit. Ligji përkatës e cakton decidivisht mënyrën e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Për çështje tjera ju keni edhe anëtarin nga radhët e subjektit tuaj në atë komision nga ui cili mund të kërkon informata rreth dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk ka legjislacion në Republikën e Kosovës që e cakton decidivisht çmimin e qirasë së pronave të dhëna në shfrytëzim nga Komuna e Podujevës, mirëpo atë e cakton ti Drejtor së bashku me Kryetarin e Komunës. Pra nuk ka ligj për këtë çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, paska u zgjeruar kjo temë mirëpo qëllimi ishte të sqarohemi sa më shumë për çështje të ndryshme që lidhen me procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronave publike komunale, ashtu siç parashihet me legjislacionin përkatës në fuqi kërkojmë të përfillen të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me këtë, andaj e vë në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Informatë e Drejtorisë së Arsimit, për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2019/2020

z.Agim Blakçori, Drejtor i DKA, e paraqiti informatën rreth përgatitjes për fillimin e vitit shkollor 2019/2020, ndër të tjera theksoi, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr.18/2019, të datës 29.08.2019 për kalendarin e vitit shkollor 2019/2020, viti shkollor ka filluar më 02 shtator 2019. Drejtoria e Arsimit në funksion të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ti krijuar kushtet për fillimin me kohë të vitit të ri shkollor.

Viti shkollor 2019/2020 në Komunën e Podujevës ka filluar me kohë në të gjitha shkollat, me përjashtim të shkollës “Ali Ajeti” në Sfeçël dhe “Kadri Kadriu” në Dumnice e Epërme, të cilat për shkak të punimeve që kanë qenë duke u zhvilluar nuk kanë mundur të fillojnë më datën 02.09.2019, por tani mësimi është duke u zhvilluar normalisht në të gjitha shkollat.

Furnizimi me tekste shkollore edhe këtë vit ka ndodh nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, po ashtu këtë vit kemi pak ndryshim sepse janë furnizuar me tekste mësimore grupi parafillor deri në klasën e shtatë ndërsa në klasën e tetë dhe nëntë nxënësit janë furnizuar me tekste të klasëve paraprake, gjithashtu kemi marrë masa me kohë dhe kemi zgjedhur kuadër të përgatitur dhe të kualifikuar për ti plotësuar nevojat për të gjitha shkollat në Komunën e Podujevës. Me kohë e kemi bërë edhe regjistrimin e nxënësve qoftë të grupit parafillor, në kasë të parë por edhe nxënësve në klasën e dhjetë të shkollave të mesme në Gjinnaz por edhe në shkolla profesionale. Janë një numër i projekteve që janë realizuar por edhe që janë duke u realizuar, i kemi cek edhe në informatë por prej atyre në ndërtim të objekteve shkollore, rinovime përmirësime të infrastrukturës etj që nuk dua ti përsëris sepse e keni marrë informatën me kohë dhe besoj e keni lexuar. Edhe këtë vit sikur vitin e kaluar Drejtoria e Arsimit të gjithë fëmijët që e kanë një distancë nga shtëpia në shkollë ka siguruar transport në mënyrë të

organizuar me qëllim që t'ju mundësojmë dhe t'ju lehtësojmë vijimin e shkollimit atyre fëmijëve dhe nxënësve që kanë një distancë nga shtëpia për në shkollë. Si përfundim viti 2019-2020 ka filluar pa asnjë problem dhe dua që punëtorëve të arsimit dhe nxënësve të ju uroj një vit shkollor të mbarë dhe të suksesshëm.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, pyetje për Drejtorin e DKA-së, sa kam vërejtur në këtë vit në klasë të parë kanë startuar 1341 nxënës, andaj dëshiroj të dijë si ka qenë viti i kaluar sa nxënës kanë qenë në vitin shkollor 2018-2019 të regjistruar, a kemi ngritje apo rënie.

z.Agim Blakçori, Drejtor i DKA, përgjigje Kryesuesit, këtë vit kemi 103 nxënës më pak, do të thotë kemi një rënie, dhe nëse e krahasojmë me maturantët që kanë kaluar tani nga sistemi komunal e që kemi pasë numër më të madh të maturantëve kështu që për 150 nxënës i kemi më pak këtë vit se sa vitin e kaluar në tërë sistemin e arsimit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0076567/19
Podujevë,
20 shtator 2019**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**